

STATISTIKA MBI SIGURINË RRUGORE

2023

STATISTIKA MBI SIGURINË RRUGORE 2023

Drejtor botimi: Dr. Elsa Dhuli

© Copyright INSTAT 2024

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në cilëndo formë, pa autorizimin paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.

INSTITUTI I STATISTIKAVE
Rr. Vllazën Huta,
Ndërtesa 35, Hyrja 1
Tiranë, Kodi Postar 1017
Tel: + 2233356 / 222411 4 355
Fax: 411 2222 4 355+
e-mail: info@instat.gov.al
www.instat.gov.al

Design: Gentian Suçi

TABELA E PËRMBAJTJES

PARATHËNIE	3
1. AKSIDENTE RRUGORE	4
1.1 Të vrarë dhe të plagosur në aksidentet rrugore	4
1.2 Aksidente sipas ditëve dhe orës	7
1.3 Aksidente rrugore sipas llojit, kushteve të rrugës dhe motit	7
1.4 Aksidente rrugore për mjete në qarkullim	9
2. MASAT ADMINISTRATIVE	10
3. AKSIDENTET RRUGORE SIPAS QARQEVE	10
4. SHPJEGIME METODOLOGJIKE	19



PARATHËNIE

Instituti i Statistikave (INSTAT) publikon për herë të parë një botim të veçantë mbi treguesit kryesorë të sigurisë rrugore. Analiza e statistikave të aksidenteve dhe ecuria përkatëse e tyre mbeten një nga elementet kryesorë në sigurinë e shoqërisë së sotme të lëvizshme.

Qëllimi kryesor i këtij publikimi vjetor është paraqitja e rezultateve dhe treguesve në lidhje me aksidentet rrugore, duke përfshirë numrin e aksidenteve, si dhe numrin e personave të vdekur dhe të plagosur, të klasifikuar sipas gjinisë, sjelljes së përdoruesve të rrugës, moshës dhe faktorëve të tjerë të rëndësishëm.

Siguria rrugore përbëhet nga disa komponentë kryesorë ku mund të përmendim sjelljen e drejtuesit të mjetit, sjelljen e këmbësorëve, infrastrukturën rrugore, karakteristikat e mjeteve etj. Të dhënat e marra në shqyrtim në analizë lidhur me gjokat dhe me lejet e drejtimit të pezulluara përfshijnë vetëm rastet që shkelja mund të jetë burim aksidenti.

Ky publikim i dedikuar ofron një pasqyrë të qartë të situatës aktuale në vend dhe adreson kërkesat gjithnjë në rritje për informacion statistikor nga vendimmarrësit, kërkuesit shkencor dhe akademikët në Shqipëri. Përgatitja e këtij materiali është e mundur nga burime administrative që përmbajnë të dhëna mbi aksidentet rrugore. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është institucioni i cili i siguron INSTAT-it një sistem të gjerë informacioni lidhur me aksidentet rrugore.

Bashkëpunimi me institucione të tjera dhe me politikë-bërësit rrit përgjegjësinë e INSTAT për krijimin e publikimeve të veçanta dhe për ofrimin e informacionit statistikor, i cili ndihmon në kuptimin më të mirë të realitetit dhe përballimin e sfidave të ardhshme.

INSTAT është i angazhuar të ofrojë një partneritet të vazhdueshëm dhe një bashkëpunim produktiv, siç dëshmohet edhe nga ky botim i ri.

Dr. Elsa DHULI

Drejtore e Përgjithshme, INSTAT





AKSIDENTE RRUGORE

Në vitin 2023, janë regjistruar 1.285 aksidente rrugore, ku kanë rezultuar 1.731 persona të përfshirë në aksidente. Aksidentet në 86,4 % të rasteve kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesit të mjetit dhe 13,6 % si pasojë e sjelljes së këmbësorëve.

Tabela 1: Numri i aksidenteve sipas sjelljes, 2021-2023

	2021	2022	2023
Gjithsej	1.376	1.165	1.285
Aksidente si pasojë e sjelljes së drejtuesit të mjetit	1.166	998	1.110
Aksidente si pasojë e sjelljes së këmbësorëve	210	167	175

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Numri i aksidenteve rrugore në vitin 2023, shkaktuar nga drejtuesit e mjeteve me leje drejtimi 0-3 vjet ka rënë me 12,9 %, krahasuar me një vit më parë. Drejtuesit e mjeteve me mbi 9 vite leje drejtimi kanë shkaktuar 40,0 % të aksidenteve, ndjekur nga kategoria 6-9 vjet leje drejtimi që zë 18,8 %.

Tabela 2: Aksidentet rrugore sipas eksperiencës në drejtim, 2021-2023


Eksperienca në drejtim	2021	2022	2023
Pa leje drejtimi	87	56	65
0 - 3 vjet	269	249	217
3 - 6 vjet	206	170	213
6 - 9 vjet	203	173	241
Mbi 9 vjet	525	455	514
Larguar nga vendi i ngjarjes	86	62	35

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

1.1 Të vrarë dhe të plagosur në aksidentet rrugore

Gjatë vitit 2023 vdekshmëria në aksidente rrugore ka rezultuar në 14,9 për 100 aksidente.


Grafiku 1: Numri i aksidenteve, të vrarë dhe të plagosur në aksidente rrugore, 2021-2023



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Ndër të aksidentuarit (të vrarë dhe të plagosur) gjatë tre viteve të fundit, meshkujt zënë rreth 70 % të të aksidentuarve gjithsej.

Grafiku 2: Të aksidentuar (të vrarë dhe të plagosur) sipas gjinisë



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Numri më i lartë i aksidenteve, në këtë periudhë, është kryer nga grup-mosha 25-34 vjeç, duke zënë 26,6 % të numrit të aksidenteve gjithsej.

Tabela 3: Aksidente rrugore sipas moshës së drejtuesit të mjetit, 2021-2023


Grup-mosha	2021	2022	2023
0 - 16 vjeç	9	5	11
16 - 25 vjeç	282	213	236
25 - 34 vjeç	371	322	342
35 - 45 vjeç	251	213	235
45 - 60 vjeç	247	229	274
Mbi 60 vjeç	129	123	153
Larguar nga vendi i ngjarjes	87	60	34

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Drejtuesit e mjeteve të moshës 25-34 vjeç, shkaktojnë numrin më të lartë të aksidenteve, ku të aksidentuar janë më shumë meshkuj 71 % dhe 29 % femra.

Megjithatë vihet re se janë meshkujt ata që zënë përqindjen më të lartë të të aksidentuarve për çdo grupmoshë të drejtuesit, duke lënë të kuptojmë se drejtuesit meshkuj janë ata që kryejnë pjesën më të madhe të aksidenteve rrugore.

Grafiku 3: Të vrarë dhe të plagosur sipas gjinisë dhe moshës së drejtuesit të mjetit, 2023



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

1.2 Aksidente sipas ditëve dhe orës

Në 2023, numri më i lartë i aksidenteve rrugore ka ndodhur gjatë ditës së Shtunë dhe të Diel me 194 aksidente secila duke zënë përkatësisht 15,1 % të aksidenteve gjithsej.

Numri më i lartë i aksidenteve ka ndodhur gjatë intervalit kohor 08:00 - 12:00.

Tabela 4: Aksidente rrugore sipas ditëve të javës, 2021-2023

Ditët e javës	2021	2022	2023
E Hënë	191	169	189
E Martë	175	175	186
E Mërkurë	196	163	182
E Enjte	200	162	158
E Premte	210	167	182
E Shtunë	206	161	194
E Diel	198	168	194

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Tabela 5: Aksidente rrugore sipas orës së ndodhjes së aksidentit, 2021-2023


Harku kohor	2021	2022	2023
00.00 - 06.00	65	70	82
06.00 - 08.00	82	54	81
08.00 - 12.00	288	219	284
12.00 - 14.00	190	151	159
14.00 - 17.00	257	216	243
17.00 - 19.00	193	204	182
19.00 - 24.00	301	251	254

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

1.3 Aksidente rrugore sipas llojit, kushteve të rrugës dhe motit

Në vitin 2023, numri më i lartë i aksidenteve rrugore ka ndodhur në rrugët urbane kryesore duke zënë 27,4 %, pasuar nga rrugët interurbane dytësore me 25,6 % të aksidenteve rrugore gjithsej.


Grafiku 4: Aksidente rrugore sipas llojit të rrugës, 2021-2023



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Numri më i lartë i aksidenteve rrugore, edhe për vitin 2023, ka ndodhur në mot të thatë duke zënë 89,1 % të aksidenteve gjithsej.


Grafiku 5: Aksidente rrugore sipas motit, 2021-2023



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Për vitin 2023, numri më i lartë i aksidenteve rrugore është shënuar gjatë orëve të ditës, duke zënë 65,4 % të aksidenteve gjithsej.

Grafiku 6: Aksidente rrugore sipas kushteve të ndriçimit, 2021-2023




Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Ilogaritjet INSTAT.

1.4 Aksidente rrugore për mjete në qarkullim

Raporti i aksidenteve për mjete rrugore në qarkullim ka pësuar rënie nga 2021, përkatësisht rënie me 0.04 pikë përqind ndërkohë ka qëndruar konstant më 2022-2023.

Grafik 7: Aksidente rrugore për 1.000 mjete rrugore në qarkullim 2021-2023



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe DPSHTRR, Ilogaritjet INSTAT.




MASAT ADMINISTRATIVE


MASAT ADMINISTRATIVE

Në 2023, masat administrative janë rritur me 18,0 %, krahasuar me vitin 2022. Numrin më të madh të masave administrative e zë "Mosrespektimi i normave të shpejtësisë" me 24,8 % dhe "Mosrespektimi i sinjalizimeve rrugore" me 12,1 %.

Grafiku 8: Llojet e kundërvajtjeve rrugore, 2021-2023 (%)



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT



AKSIDENTET RRUGORE SIPAS QARQEVE

AKSIDENTET RRUGORE SIPAS QARQEVE

Numri më i lartë i aksidenteve në vitin 2023 ka ndodhur në qarkun e Tiranës duke zënë 42,6 % dhe në qarkun e Durrësit duke zënë 12,3 % të aksidenteve rrugore gjithsej. Qarku me numrin më të vogël të aksidenteve rrugore është Dibër me 2,0 % dhe Berat me 2,3 % të aksidenteve rrugore gjithsej.

Tabela 6: Numri i aksidenteve sipas qarqeve, 2021-2023

Qarku	2021	2022	2023
Berat	33	28	30
Dibër	22	7	26
Durrës	114	78	158
Elbasan	57	41	50
Fier	118	65	80
Gjirokastrë	86	78	70
Korçë	59	57	57
Kukës	49	50	38
Lezhë	168	149	115
Shkodër	26	26	33
Tiranë	627	541	547
Vlorë	17	45	81
Gjithsej	1.376	1.165	1.285

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Ilogaritjet INSTAT

Tabela 7: Aksidente rrugore për 1.000 mjete rrugore në qarkullim, 2021-2023

Qarku	2021	2022	2023
Berat	1.1	0.9	0.9
Dibër	1.1	0.3	1.1
Durrës	1.2	0.7	1.4

Elbasan	1.1	0.7	0.8
Fier	1.7	0.9	1.0
Gjirokastrë	5.1	4.4	3.7
Korçë	1.6	1.4	1.3
Kukës	2.9	2.7	1.9
Lezhë	4.6	3.8	2.7
Shkodër	0.5	0.5	0.5
Tiranë	2.4	2.0	1.8
Vlorë	0.3	0.8	1.3
Gjithsej	1.9	1.5	1.5

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

SHPIEGIME

7 3 1 7 5 1 2 0 3 A 2 5 4 6 8 7 8 3 1 5 1 9 0 7 5 9 C 0 D

METODOLOGJIKE

4. SHPJEGIME METODOLOGJIKE

Të dhënat e publikimit “Statistika mbi Sigurinë Rrugore” sigurohen nga burime administrative. Përgatitja e këtij materiali është mundësuar nga burime administrative të cilat sigurojnë një rrjet të gjerë informacioni mbi aksidentet rrugore si: ndryshimi në numrin e aksidenteve vjetore, numrit të personave të vrarë dhe të plagosur nga aksidentet rrugore, sjelljes së përdoruesve të rrugës, moshës dhe qarqeve.

Aksidentet në trafikun rrugor përfshijnë vetëm aksidentet që shkaktojnë vdekje apo plagosje. Mundësitë për ndodhjen e aksidenteve rrugore mund të lidhen me një sërë faktorësh, si numri i kilometrave të përshkruar, shtrirja dhe cilësia e infrastrukturës rrugore, kushtet klimaterike dhe gjeografike, dendësia e popullsisë. Sjellja e drejtuesve të mjeteve mund të përbëjë gjithashtu shkak për mundësitë e ndodhjes së aksidenteve, si p.sh. trajnime të papërshtatshme ose eksperiencia, mungesa e përqëndrimit, shpejtësia tej normave të lejuara, mosrespektimi i rregullave të qarkullimit si dhe konsumi i pijeve alkolike.

Masa administrative me gjobë konsiston në pagesën e një shume parash ndërmjet një kufiri minimal dhe një kufiri maksimal sipas rastit. Kjo masë vendoset në bazë të rëndësisë së shkeljes, punës së kryer nga personi për mënjanimin ose zbutjen e pasojave të shkeljes, si dhe personalitetit dhe kushteve të tij ekonomike.

PËRKUFIZIME:

Aksidente: Ngjarje e papritur, e padëshiruar ose e paqëllimshme ose një zinxhir specifik ngjarjesh të tilla që sjellin pasoja të dëmshme

Aksident me pasoja: Çdo aksident që përfshin të paktën një automjet rrugor në lëvizje në një rrugë publike ose private në të cilën publiku ka të drejtë hyrjeje, duke rezultuar në të paktën një person të plagosur ose të vrarë.

I vdekur: Çdo person i cili ka vdekur menjëherë ose brenda 30 ditëve si rezultat i aksidentit, përjashtuar vetëvrasjet.

I plagosur: Çdo person i cili si rezultat i një aksidenti nuk u vra menjëherë ose nuk vdiq brenda 30 ditësh, por pësoi një dëmtim për të cilin lind nevoja e një trajtimi mjekësor, duke përjashtuar vetëvrasjet në përpjekje.

Sjellja e Drejtuesit të Mjetit: Nënkupton aksidentet që ndodhin kur drejtuesi i mjetit nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas “Kodit Rrugor” si: frenim i papritur, mosrespektimi i shenjave (sinjalistikës) së trafikut, mosrespektimi i normave të shpejtësisë, etj.

Sjellja e Këmbësorëve: Nënkupton aksidentet që ndodhin kur këmbësori nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas “Kodit Rrugor” si: kalim rruge pa kujdes, etj.

Autostradë: Rrugë interurbane ose urbane me karrexhata të pavarura ose të ndara nga trafikndarës të pakapërcyeshëm, secila me të paktën dy korsi lëvizjeje, bankinë të shtruar të mundshme në të majtë dhe korsi emergjence, ose bankinë të shtruar në të djathtë, pa kryqëzime në nivel, e pajisur me rrethim dhe sisteme asistence për përdoruesin gjatë gjithë gjatësisë, e rezervuar për qarkullimin e disa kategorive mjeteve me motor dhe e dallueshme me sinjale të vecanta të fillimit dhe mbarimit.

Rrugë interurbane kryesore: Rrugë me karrexhata të pavarura ose të ndara nga trafikndarës të pakapërcyeshëm, secila me të paktën dy korsi lëvizjeje dhe bankina të shtruara, pa kryqëzime në nivel, me hyrje të koordinuara për objekte anësore, e dallueshme nga sinjale të veçanta të fillimit dhe mbarimit, e rezervuar për qarkullimin e disa kategorive mjetesh me motor.

Rrugë interurbane dytësore: Rrugë me një karrexhatë me të paktën një korsi lëvizjeje për sens dhe bankina.

Rrugë urbane kryesore: Rrugë me karrexhata të pavarura, ose të ndara nga trafikndarës, secila me të paktën dy korsi lëvizjeje dhe një korsi e mundshme e rezervuar për mjete publike, bankina të shtruara dhe trotuare, me kryqëzime në nivel të pajisura me semafor. Për qëndrimin janë parashikuar zona ose breza anësore jashtë karrexhatës, të dyja me hyrje dhe dalje të përqendruara.

Rrugë urbane dytësore: Rrugë me një karrexhatë me të paktën dy korsi, bankina të shtruara dhe trotuare. Për qëndrimin janë parashikuar zona të pajisura me korsi manovrimi jashtë karrexhatës.

Rrugë lokale: Rrugë urbane ose interurbane, e sistemuar në mënyrë të përshtatshme sipas përkufizimeve të pikës 1 të këtij neni, por që nuk bën pjesë në rrugët e mësipërme.

Masa administrative: Gjoha konsiston në pagesën e një shume parash ndërmjet një kufiri minimal dhe një kufiri maksimal sipas rastit. Kjo masë vendoset në bazë të rëndësisë së shkeljes.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Instituti i Statistikave

Statistika mbi sigurinë rrugore : 2023 / Instituti i Statistikave ; drejt. bot. Elsa Dhuli. - Tiranë : INSTAT, 2024.

... f. : me il. ; ... cm.

ISBN 9789928390233

1.Transporti rrugor 2.Aksidente 3.Parandalimi i aksidenteve 4.Statistika 5.Shqipëri

311.312(496.5) "2023" :351.81

STATISTIKA MBI SIGURINË RRUGORE 2023